

Forma optimale e krasitjes në kultivarin e hershëm "Victoria"

Objektivi i studimit: Ndikimi i ngarkesës në sytha në aspektin e rendimentit dhe cilësisë së prodhimit.

Kultivari në provë:

"Victoria". Mund të aplikohet në të gjithë kultivarët për tryezë me aftësi prodhuese të sythave bazalë si "Black Magic", etj.

Vendi i ngritjes së studimit:

Cerkoivnë – Vlorë.

Varjantet në provë:

V1: ngarkesa 12 sytha (6 x 2)

V2 : ngarkesa 20 sytha(6 x 2+ 1 X 8).

V3 : ngarkesa 10 sytha(5 x 2)

Rezultatet e studimit (viti 2011).

Rritja e ngarkesës nga 10 në 12 dhe 20 sytha për bimë rezulton me:

- rritje prodhimi respektivisht 11 dhe 49%.

- ujle të përmbajtes së sheqerit 0.2 dhe 0.9%.

- ujle të peshës së bistakut me 11 dhe 42 gram/ bistak.

- Lënia e sharmendës prodhuese sjell pasoja negative në uniformitetin e pjekjes dhe rritjen e fenomenit të padëshiruar të milerandimit, duke ndikuar direkt në uljen e pamjes tregëtare dhe vështirësimin e tregëtimit të prodhimit.

-Në të njëjtën kohë, prezenca e lastarëve të shumtë të sharmendës, krijon vështirësi në mbrojtjen e rrushit nga sëmundjet dhe dëmtuesit, pastërtia e të cilit përbën faktor kryesor në pamjen tregëtare.

Treguesit e prodhimit dhe efektiviteti ekonomik:

Varianti	Prodh. Gr/bimë	Përmb. sheq. (%)	Të ardhura (%)
12 sytha (6 x2)	4066	12.4	111
20 sytha (6x2 +1x8)	5480	11.7	115
10 sytha (5x2)	3673	12.6	100

Konkluzion

Ngarkesa me sytha në bimë gjatë krasitjes dimërore ndikon direkt në rendimentin dhe cilësinë e prodhimit të rrushit.

Pavarësisht nga një shtesë e vogël në treguesin e të ardhurave, lënia e sharmendës prodhuese në cv."Victoria" influencon negativisht në treguesit cilësorë të prodhimit.